

"INTER DISTRIBUTION SERVICES" SH.P.K.
Regjistruar me Vendim Gjykatë nr. 37944, dt. 05.04.2007.
NUIS: K71612801P.
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, Shqipëri.

VENDIM

I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

"INTER DISTRIBUTION SERVICES" SH.P.K.

Nr. 22, Datë 18.04.2024.

Sot, më datë 18.04.2024, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "INTER DISTRIBUTION SERVICES" sh.p.k., me adresë në: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, e regjistruar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 37944, më datë 05.04.2007, me NUIS K71612801P, e përbërë nga zotëruesit e 100% të kuotave të kapitalit:

1. **Shoqëria me Pëgjegjësi të Kufizuar "Investment Joti – Infosoft Group"**, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë, më datë 25.02.2009, me NUIS K91425022E, me Administrator Znj. Blerta Elezaj, e cila zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.
2. **Z. Plarent Kristo**, i cili zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.
3. **Z. Roland Joti**, i cili zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.

Duke qenë se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve plotëson kuorumin e caktuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Asambleja ka për rend dite:

- Diskutim në lidhje me zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k.

Në përputhje me nenin 9.8 të Statutit të shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k., i ndryshuar më dt. 06.12.2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me unanimitet,

VENDOSI:

1. Zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k. nga 91,000,000 (nëntëdhjetë e një milion) lekë në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë, nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të kuotës së secilit Ortak, në përputhje me përqindjet respektive të pjesëmarrjes së Ortakëve në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
2. Në përfundim të procesit të zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k., kapitali i regjistruar i saj bëhet 1,000,000 (një milion) lekë. Vlera prej 90,000,000 (nëntëdhjetë milion) lekë me të cilën zvogëlohet kapitali do t'u paguhet Ortakëve në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në kapital. Përqindjet respektive të pjesëmarrjes së Ortakëve në kapital nuk do të ndryshojnë, ndërsa vlera nominale e kuotës për secilin prej Ortakëve do të ndryshojë si më poshtë:

Nr.	Ortakët	Vlera e kapitalit para zvogëlimit		Vlera e kapitalit pas zvogëlimit	
		Vlera nominale (lekë)	Në %	Vlera nominale (lekë)	Në %
1.	Investment Joti – Infosoft Group sh.p.k.	30,333,333.333	33.333%	333,333.333	33.333%
2.	Plarent Kristo	30,333,333.333	33.333%	333,333.333	33.333%

3.	Roland Joti	30,333,333.333	33.333%	333,333.333	33.333%
TOTALI		91,000,000	100%	1,000,000	100%

3. Vlera prej 90,000,000 (nëntëdhjetë milion) lekë me të cilën zvogëlohet kapitali i shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k. rezulton nga kontributet në para të Ortakëve të Shoqërisë, sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 93, dt. 11.04.2019, për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë me kontribute monetare të Ortakëve. Në përputhje me Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", duke qënë se është zvogëlim i kapitalit qe rrjedh nga kontributet në para të Ortakëve, mbi vlerën e sipërcituar nuk aplikohet mbajtja e tatimit në burim.
4. Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore.
5. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, departamenti ligjor dhe departamenti i financës për ekzekutimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT

"Investment Joti-Infosoft Group" sh.p.k.

Blerta ELEZAJ



Plarent KRISTO

Roland JOTI

